

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të administratës shtetërore (“Gazeta zyrtare e RM” nr.58/00 dhe 44/02) dhe neni 24 dhe 26 të ligjit për arsim të mesëm (“Gazeta zyrtare e RM” nr.44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/ 06, 70/06 dhe 51/07), ministri i arsimit dhe shkencës miratoi program mësimor në lëndën fakultative projekte nga artet figurative për klasën e VI të arsimit fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e VII, VIII ose IX për arsimin fillor nëntëvjeçar.

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS  
ENTI PËR ZHVILLIMIN E ARSIMIT

**PROGRAMI MËSIMOR**

**PROJEKTE NGA ARTET FIGURATIVE**

LËNDË FAKULTATIVE

ARSIMI FILLOR

## 1. HYRJE

Lënda mësimore *projekte nga artet figurative* është lëndë fakultative që nxënësit mund ta zgjedhin arsimit fillor nëntëvjeçar (në klasën të VII, të VIII ose të IX). Fondi javor i orëve të kësaj lënde është 2 orën në javë, përkatësisht 72 orë gjatë gjithë vitit shkollor.

Lënda mësimore *projekte nga artet figurative* me veçantitë e saj mundëson kënaqjen e interesit të nxënësit për krijimtari figurative dhe nëpërmjet krijimtarisë dhe kulturës figurative të zhvillohet individualiteti, senzibiliteti dhe aftësitë e tij figurativ-krijuese.

Liria e zgjedhjes të shprehjes figurative është faktor i rëndësishëm për nxitjen e interesit të nxënësve, si dhe të përjetimit të kënaqësisë të madhe nga rezultati i arritur. Vlerësimi spontan estetik i rezultatit të arritur i bën aktivitet projektuese të dëshirueshme për nxënësin dhe kontribuojnë për krijimin e një atmosfere dhe kënaqësie relaksuese.

Projektet nga arti figurativ do të realizohen në dy fusha:

-teoria e artit figurativ (historia e artit, gjuha e artit figurativ – elemente dhe principe, kritike e artit figurativ – vlerësim estetik – analiza e veprave të artit figurativ – autorë, këndvështrime dhe mendime individuale);

-praktikë e artit figurativ (punë krijuese – realizimi i krijimeve në material –vizatim, pikturim, skulpturë,grafikë, dizajn dhe komunikacione vizuale (art bashkëkohor).

### SHËNIM:

**Në pajtim me dinamikën për futjen e edukimit dhe arsimit fillor nëntëvjeçar programi mësimor për nxënësit e klasës të VI të arsimit fillor tetëvjeçar të vitit shkollor 2008/09 është ekuivalent me programin mësimor për klasën e VII, të VIII ose të IX të arsimit fillor nëntëvjeçar.**

## **2. SYNIMET E ORËS TË MËSIMIT PËR KLASËN E VII, VIII OSE TË IX**

Nxënësi/ nxënësjja:

- të nxitet të marr pjesë në projekte nga arti figurativ;
- të aftësohet të përcaktohet për një projekt dhe fazat e realizimit të tij;
- t'i zhvilloj aftësitë krijuese për shprehje në artin figurativ;
- të bëj dallimin midis stileve dhe artistëve;
- të di të vëzhgoj, vërej dhe vlerësoj vlera dhe përmbajtje të artit figurativ tek veprat e artit figurativ dhe ta shpreh mendimin e vet;
- t'i shpreh karakteristikat e veta individuale në organizimin në punë, komunikim dhe në shprehjen krijuese;
- të tregoj interes për ndryshim dhe intervenim estetik në ambientin ku mëson dhe jeton;
- të dalloj terma dhe të përdor terma profesional në punën dhe komunikimin për artin figurativ;
- të jetë i aftë të transformoj përmbajtje të natyrës, fantazisë ose nga burime të tjera në krijim artistik;
- të jetë i aftë të aranzhoj ekspozitë personale ose të përbashkët në kuadër të shkollës;
- të kërkoj dhe të eksperimentoj në zbatimin e elementeve të artit figurativ, materialet dhe teknikat, bazament për punë dhe formatin e veprës;
- të përdor teknologji kompjuterike në projektimin e skicave dhe punë tjetër në krijimtarinë e artit figurativ dhe dizajni;
- të përdor materiale dhe teknika alternative për t'u shprehur artistikisht.

## **3. SYNIME KONKRETE**

<b>Projekt: hyrje në historinë e artit figurativ</b>			
<b>Synime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Terma</b>	<b>Aktivitete dhe metoda</b>
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <p>-të aftësohet ta zbatoj metodologjinë për bërjen e një projekti nga arti figurativ</p> <p>-të njihet me ndonjë stil të caktuar artistik, vepra të ndonjë autori të caktuar, grup autorësh etj.;</p> <p>-të aftësohet të bëj prezantim të hulumtimit (stil artistik, vepra të ndonjë autori të caktuar, grup autorësh etj.)</p>	<p>Hulumtim përpilim të:</p> <p>-ndonjë stili të caktuar artistik;</p> <p>-ndonjë vepre të caktuar artistike;</p> <p>-opus të ndonjë artisti të caktuar</p>	<p>-Stil artistik</p> <p>-Vepër e artit figurativ</p> <p>-Krijues-krijim</p> <p>-Krijues-autor</p>	<p>-Studimi i literaturës përkatëse për stil të caktuar;</p> <p>-shfaq material vizuar (slajde, video etj.);</p> <p>-hulumtimi i veçorive të një vepre të caktuar (autor, stil etj.) nga aspekti i elementeve të artit figurativ, teknikës, dimensioneve, kohës të bërjes etj.;</p> <p>-bisedë me ndonjë artist ose persona të tjerë;</p> <p>-përgatitje teksti dhe shfaqje të materialit vizual për hulumtimin;</p> <p>-përgatitja e materialit të ashkruar dhe vizual dhe prezantim para nxënësve.</p>

**Projekt: kritikë e artit figurativ**

<b>Synime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Terma</b>	<b>Aktivitete dhe metoda</b>
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <p>-të njihet me elementet bazë të kritikës të artit figurativ;</p> <p>-të aftësohet të shkruaj kritikë të thjeshtë për ndonjë ekspozitë (në shkollë, ekspozitë për fëmijë etj.).</p>	<p>Kritikë artistike</p>	<p>-Autor</p> <p>-Analizë</p> <p>-Kritikë e artit figurativ</p>	<p>-leximi i kritikave artistike për ekspozita të artit figurativ</p> <p>-vizita e ndonjë ekspozite të artit figurativ (fëmijës dhe artistësh);</p> <p>-shkrim i ndonjë teksti sipas përshtypjeve dhe këndvështrimeve personale;</p> <p>-prezantimi i tekstit (me material vizual) para nxënësve.</p>
<b><i>Projekt: gjuha e artit figurativ</i></b>			
<b>Synime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Terma</b>	<b>Aktivitete dhe metoda</b>
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <p>-të njihet me zhvillimin e gjuhës të artit figurativ dhe rolin në shprehjen artistike;</p> <p>-t'i dalloj elementet artistik karakteristik në fusha të veçanta të artit figurativ;</p> <p>-të shqyrtoj dhe studioj stile dhe drejtime të ndryshme dhe të dalloj se cili element dhe princip artistik përdoret më shpesh.</p>	<p>Rëndësia e gjuhës artistike në krijimtarinë artistike</p> <p>Karakteristikat e gjuhës artistike në vizatim, pikturë, grafikë, skulpturë dhe dizajn</p> <p>Analizë e dominimit të elementeve të caktuar artistik në stil të caktuar artistik, grup autorësh ose krijues.</p>	<p>-Gjuha e artit figurativ</p> <p>-Fusha të artit figurativ</p>	<p>-Studimi i literaturës përkatëse (p.sh. shkolla Bauhaus) për analizë të veprave artistike;</p> <p>-shikimi i veprave origjinale dhe të reproduksioneve, studim literature, bisedë dhe ekspert;</p> <p>-hulumtim me temë (nga fusha e gjuhës artistike figurative) sipas dëshirës të nxënësve dhe prezantimi i saj.</p>

***Projekt: Vizatim***

<b>Synime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Terma</b>	<b>Aktivitete dhe metoda</b>
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <p>-të aftësohet të bëj skica si parapërgatitje për realizimin e veprës artistike;</p> <p>-të aftësohet të bëj vizatim, studim, portret, peizazh;</p> <p>Të aftësohet të përdor për vizatim materiale të reja dhe alternative: bajc supje etj dhe i hulumton mundësitë e tyre.</p>	<p>-Skica</p> <p>-Materiale të reja dhe alternative</p> <p>-Vizatim me karakteristika individuale</p>	<p>-Skicë, kroki</p> <p>-Ide artistike figurative</p> <p>-Vizatim (artistik, teknik, shkencor)</p> <p>-Studim, portret, peizazh, figurë</p> <p>-Modelim, raporti dritë-errësirë dhe dritë-hije</p>	<p>-Bërja e skicave për realizimin e zgjidhjes më të mirë artistike;</p> <p>-realizimi i idesë artistike – vizatim në copë;</p> <p>-bërja e studimit të një portreti, figure, peizazhi etj. dhe zgjidhja e efektit tredimensional me gradim tonik;</p> <p>Bërja e vizatimit me karakteristika individuale nëpërmjet zgjedhjes të lirë të elementeve, teknikës, motivit etj. artistik</p>
<b>Projekt: Pikturë</b>			
<b>Synime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Terma</b>	<b>Aktivitete dhe metoda</b>
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <p>-të nxitet të eksperimentoj dhe krijoj skicë kolorite për bërjen e një vepre artistike (monumentale, format galerie etj.);</p> <p>-të aftësohet të pikturoj figurë (a) në lëvizje sipas zgjedhjes personale të motivit dhe teknikës;</p> <p>-t'i përvetësoj dhe t'i përdor teknikat e pikturimit me polikolor, akril, vaj, vitrazh, mozaik, kolazh ose grafit(duke përdorur materiale natyrore);</p>	<p>Skicë kolorite në bërjen e një vepre monumentale</p> <p>Dinamizëm në shprehjen artistike</p> <p>Teknika të reja pikturimi dhe veçoritë e tyre</p> <p>Veprat artistike figurative monumentale dhe karakteristikat e tyre</p>	<p>-lloje skicash: vizatim, me ngjyra dhe ai tredimensional</p> <p>-Akril, vaj, vitrazh</p> <p>-Freske, mural, grafit</p> <p>Hepening artistik, koloni artistike</p>	<p>-Hulumtim: skica në formën e vizatimeve, kolorite dhe figurative (tredimensionale)</p> <p>-kundrim fotografish, veprash artistike figurative etj me gjendje statike dhe dinamike;</p> <p>-hulumtim: veçoritë e teknikave të ndryshme dhe demonstrohet ekspozitë e realizimit të tyre;</p> <p>-hulumtim: ndryshimet e teknikave të zakonshme tek piktura monumentale: freske (alfresco dhe alseko), mozaik etj.;</p>

<p>- të aftësohet të bëj skica si për realizimin e krijimit artistike të formatit të madh;  -të aftësohet të marr pjesë në krijimin e pikturës të formatit të madh për rregullim e shkollës brenda dhe jashtë;  -të nxitet të marr pjesë në hepening artistik figurativ, koloni artistike për fëmijë etj me rastin e ndonjë evenimenti (dita e verës, festë patronazhi etj)</p>	<p>Forma të ndryshme të aktivitetit artistik figurativ</p>		<p>-Organizimi i hepeningut artistik, ose formë tjetër pune në kuadër të shkollës;   -Organizimi i kolonisë artistike për fëmijë;</p>
---	--	--	---

<i>Projekt: Skulptura</i>			
<b>Synime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Terma</b>	<b>Aktivite dhe metoda</b>
<p>Nxënësi/nxënësja:   -të aftësohet të bëj skica në vizatim dhe tredimensionale në glinë (dhe material tjetër) si parapërgatitje për skulpturën;   -të aftësohet të bëj skulpturë në material me principin e heqjes (dru, gur, rrënjë);   -të aftësohet të modeloj forma tredimensionale me përdorjen e letrës (origami, kashim, konstruktion etj.).</p>	<p>-Ide artistike dhe bërja e skicës   Lloje të modelimit figurativ  Rëndësia e raportit midis ambientit dhe skulpturës (forma tredimensionale)   Origami si art</p>	<p>-Ide artistike figurative  -Skicë   -Teknikë skulpture  -Statikë  -Princip i shtimit – heqjes   -Ambient, enterier – eksterier, formë figurative, tavolinë   Origami, kashim, konstruim.</p>	<p>-Bërja e skicës në realizimin e idesë artistike;   -hulumtim: dallimi i statikës të disa lloje bimësh dhe konstrukcioni i tyre;   -Demonstrim: modelim skulpture me zbatimin e procedurës të shtimit dhe heqjes;   -Përgatitja e një projekti në skulpturë (figurative ose abstrakte) për zbulimin një ambienti të caktuar;</p>



			-demonstrimi i teknikave të ndryshme të përdorimit të letres si material artistik figurativ. -Punim origami.
--	--	--	---

<b>Projekt: Grafikë</b>			
<b>Synime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Terma</b>	<b>Aktivitete dhe metoda</b>
<p>Nxënësi/nxënësjat:</p> <p>-Të njihet me karakteristikat dhe procesin e bërjes të grafikës;</p> <p>-të aftësohet të realizoj monotipi, linorez dhe grafikë në karton-vulë me dy a më shumë ngjyra;</p> <p>-të aftësohet të bëj kallëpe për karton-vulë, linorez, gipsorez sipas përfytyrimit dhe skicës të vetë;</p> <p>-të aftësohet të bëj grafikë kompjuterike dhe varacione e transformimi të saja në softuer përkatës.</p>	<p>Grafika si fushë artistike figurative</p> <p>Proces grafik</p> <p>Veprime dhe mjete në shprehje grafike</p> <p>Grafikë kompjuterike</p>	<p>Skica, zgjidhje grafike</p> <p>-Fletë grafike</p> <p>-Stampë grafike</p> <p>-Presë</p> <p>-Vegël dhe pajisje grafike</p> <p>-Kallëp për vulë të lartë</p> <p>-Grafikë kompjuterike</p> <p>-Softuer grafik</p>	<p>-Vizitë në atelienë e ndonjë artisti, vëzhgimi i procesit të krijimit dhe realizimit të veprës artistike-grafikë.</p> <p>-kundrim skice, matrice dhe grafike të të njëjtit krijim, vepër dhe zbulimi karakteristikave dhe veçantive, si dhe roli i tyre në procesin grafik;</p> <p>-bërja e disa skicave për grafikë, zgjedhja e njërës dhe realizimi i saj në grafikë.</p> <p>-Hulumtim: specifika të monotipisë me një a më shumë ngjyra.</p> <p>-Realizimi i grafikës me dy ngjyra në teknikën karton-vulë.</p> <p>-shtypja në presë grafike të matricës (linorez, gipsorez).</p> <p>-Bërja e grafikës kompjuterike sipas skicës, të njëjtën e transformon në tjetër grafikë me shtimin dhe fshirjen e elementeve, me ndryshimin e ngjyrave, me intervenime, kombinim dhe kompozim të elementeve artistik.</p>

<b>Projekt: Dizajn dhe komunikacione vizuale (arti bashkëkohor)</b>			
<b>Synime</b>	<b>Përmbajtje</b>	<b>Terma</b>	<b>Aktivitete dhe metoda</b>
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <p>-të aftësohet të bëj dizajnin e një objekti të caktuar (nga skica deri në produktin final);</p> <p>-të njihet me artin dhe estetikën në teatër;</p> <p>-të njihet me mënyrën e realizimit të një zgjidhje artistike (kostumografi dhe skenografi) për një shfaqje teatrale;</p> <p>-të njihet me fotografinë dhe videon si mënyrë artikulimi artistik.</p>	<p>Arti bashkëkohor dhe karakteristikat e tij</p> <p>Dizajni industrial dhe aplikimi i tij</p> <p>Arti dhe teatri</p> <p>Roli i fotografisë në jetën e përditshme dhe roli i fotografisë në dizajn</p> <p>Videoja si medium artistik - figurativ</p>	<p>-Arti bashkëkohor</p> <p>-Dizajn industrial</p> <p>-Mjet utilitar</p> <p>-Logo</p> <p>-Pllakat</p> <p>-Teknikë e kombinuar</p> <p>-Kostum</p> <p>-Kostumografi</p> <p>-Skenë</p> <p>-Skenografi</p> <p>-Fotografi artistike</p> <p>-Videoart</p>	<p>-Hulumtim: dizajnë të ndryshme; krahasim i veshjeve të burra, gra, tinxherë dhe fëmijë, për sezone dhe raste të ndryshme.</p> <p>-Hulumtim: dizajni industrial (dizajn për prodhim në seri)</p> <p>-Realizim dizajni për nevojë konkrete të shkollës.</p> <p>-Projekt për dizajn industrial të një celulari, makine, mobilie, ambalazh etj.</p> <p>-realizim ideje në material – bën maket ose model të një objekti utilitar duke e ndjekur skicë personale.</p> <p>-realizimi i një zgjidhje ideore për pllakat, logo, ftesë etj për jubile, ekspozitë, patronit etj.</p> <p>-Vizitë në teatër, vështrim kostumesh, skenash për shfaqje të ndryshme.</p> <p>-Vizitë në ekspozitë fotografish, shqyrton Internet sajte për fotografi artistike dhe marketingu.</p> <p>-Realizimi i fotografive artistike për nevojat e shkollës.</p> <p>-Realizimi i filmave te shkurtër të lidhur me jetën e përditshme personale dhe të shkollës.</p>

#### **4. REKOMANDIME DIDAKTIKE**

Lënda mësimore fakultative *projekte nga arti figurativ* jep mundësi integrimi në përmbajtjen e programit të arsimiit artistik, si dhe në përmbajtjet e lëndëve të tjera mësimore. Gjithashtu, ka mundësi për integrim të brendshëm në përmbajtjet e aktiviteteve të projektuara. Mësuesi duhet t'i ndihmoj nxënësit që t'i përvetësojnë fazat dhe hapat në përpilimin e projektit (zgjedhja e temës, përcaktimi i qëllimit, formimi i ekipit, ndarja e roleve, planifikimi i aktiviteteve, përcaktimi i kuadrit kohor). Në program ofrohen disa lloje projektesh nga fusha të ndryshme (teori artistike dhe praktikë artistike). Sipas modele të gatshëm mësuesi mund të bëj projekte të veta dhe tua ofroj ato nxënësve. Zgjedhja e projekteve dhe caktimi i numrit të tyre për një vit shkollor bëhet sipas vlerësimit të mundësive dhe afiniteteve të nxënësve (p.sh. nëpërmjet anketimit të nxënësve). Kohëzgjatja e një projekti caktohet nga mësuesi, sipas llojit të projektit (nga një semestër tremujor deri në një vit shkollor). Për përpilimin e kuadrit kohor të një projekti mësuesi duhet të caktoj disa orë për prezantimin përfundimtar. Gjatë një viti shkollor një nxënës mund të realizoj deri në 4 projekte.

- *Mjete mësimore:*

- udhëzues për mësuesin;

- mjete dhe materiale didaktike

- mjete vizuale (objekte të mjedisit përreth, reproduksione, krijime fëmijësh, aplikime etj.);

- sljade, revista etj.;

- mjete audio-vizuale (TV, DVD-pleer, videopleer, fotoaparati dixhital, kamera dixhitale, kompjuter dhe mjete të tjera në varësi të objektit);

-Internet, softuerë arsimor;

#### **5 MËNYRA E NDJEKJES DHE E VLERËSIMIT TË ARRITJEVE TË NXËNËSVE**

Gjatë mësimit ndiqen dhe vlerësohen rregullisht arritjet e nxënësve, mblidhen tregues për aktivitetet e tyre, motivimi për shprehje artistike, angazhimi i nxënësve, përkushtimi në punë, bashkëpunimi me të tjerët dhe aktivitetet e tyre shprehëse, etj. (vlerësim formativ). Gjatë ndjekjes të arritjeve të nxënësve, mësuesi duhet të bëjë kujdes me qasjen individuale kundrejt çdo nxënësi.

Nxënësi vlerësohet me notën.

## **6 KUSHTE E AMBIENTIT PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR**

Programi në lidhje me kushtet e ambienteve bazohet në Normativën për ambient, pajisje dhe mjete mësimore për shkollën fillore nëntëvjeçare, të miratuar nga ministri i arsimit dhe shkencës me Vendim nr. 07-1830/1 të datës 28.02.2008.

## **7 NORMATIVA PËR KUADROT MËSIMDHËNËS**

Punën edukuese-arsimore e kryen person që ka mbaruar:

- Fakultetin e arteve figurative – drejtimi pedagogji;
- Fakultetin e arteve figurative – që ka dhënë provime pedagogjike shtesë në FAP.

## **8 REZULTATET E PRITURA**

Nxënësi / nxënësjë:

- i di fazat e hartimit të një projekti nga arti figurativ (planifikimin i aktiviteteve dhe të kuadrit kohor, role, faza në realizimin, prezantimin dhe vlerësimin e rezultatit);
- merr pjesë aktive në të gjitha fazat e realizimit të projektit (aftësi planifikimi, aftësi hulumtimi, aftësi për marrjen e vendimeve adekuate, ndjenjë për kohën dhe afatet e fundit, aftësi komunikuese, aftësi organizimi, aftësi për mbajtjen e evidencës – portofolio, aftësi prezantuese);
- di t'i prezantoj të dhënat e nxjerra nga hartimi i projektit (për një temë të caktuar);

- merr pjesë në bërjen e një vepre artistike nga një fushë e caktuar (vizatim, pikturë, grafikë, skulpturë, dizajn dhe komunikim vizual);
- mund të përdor kompjuter në lëndën e artit figurativ.

## **9 KOMISIONI PËR PËRGATITJEN E PROGRAMIT MËSIMOR**

1. Trajko Jovanovski, koordinator, këshilltar për lëndën mësimore të artit figurativ dhe të artit figurativ në BZHA - Veles
2. Zoran Maznovski, këshilltar për lëndën mësimore të artit figurativ dhe të artit figurativ në BZHA - Berovë
3. Ana Cvetkovska-Panova, JUDGOC “13 Nëntori” – Shkup
4. M-r Marija Nikollovska, SHF “Dane Krapçev” – Shkup
5. Nikolla Nanevski, SHF “Krste Misirkov” – Shkup

## **10 VENDIM DHE DATA E MIRATIMIT TË PROGRAMIT MËSIMOR**

Programin mësimor *projekte nga arti figurativ* për klasën e gjashtë të arsimit fillor tetëvjeçar, përkatësisht për klasën e shtatë, tetë ose të nëntë të arsimit fillor nëntëvjeçar e solli

Ministri

\_\_\_\_\_

data \_\_\_\_\_